

Plani 3-6-9 +

Hyrje

Pakoja e masave të Planit 3-6-9, të parapara për zbatim në tri muajt e parë janë përmbushur në masë të madhe, para se gjithash, si rezultat i dëshirës dhe angazhimit të fuqishëm politik të Qeverisë dhe institucioneve kompetente. Një pjesë e masave, realizimi i të cilave ka filluar ose është në rrjedhë, mbesin relevante edhe për periudhën e ardhshme.

Qeveria vendosi **mekanizëm efikas për zbatimin e masave të Planit 3-6-9:**

- Drejtimet politike i jep **Grupi Ministror i Punës** me të cilin kryeson Kryetari i Qeverisë, në të cilin krahas zëvendëskryetarit të Qeverisë, i ngarkuar për çështje evropiane si koordinatori i tërë procesit, marrin pjesë edhe ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Drejtësisë, ministri i Punëve të Jashtme, ministri i Mbrojtjes, ministri i Financave, ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, ministri pa resor i ngarkuar për komunikim, raportim dhe transparencë, dhe Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë.
- Ndjekjen e zbatimit të masave, sinjalizimin me kohë për parregullsitë në zbatim dhe sigurimin e komunikimit ditor e kryen **Grupi Ad Hok i Ekspertëve** ndërresor, me përfaqësuesit e institucioneve me të cilat udhëheqin ministrat e përfshirë në Grupin Ministror të Punës. Me Grupin Ad Hok kryeson Kabineti i Kryetarit të Qeverisë, kurse përgatitjen dhe koordinimin e kryen Sekretariati për Çështje Evropiane.
- **Vendimet politike i miraton Qeveria** dhe çdo mbledhje e saj e rregullt fillon me shqyrtimin e statusit të zbatimit të masave dhe me miratimin e vendimeve të nevojshme.

Masat e pjesës 6 dhe 9 janë përkufizuar dhe azhurnuar në bazë të rekomandimeve të përmbajtura në Raportin e Grupit të Ekspertëve të Lartë për çështjet sistematike nga sundimi i së drejtës dhe konsultimet me të gjitha palët e përfshira. Masat e parapara **planifikohet të realizohen deri në dhjetor 2017 / mars 2018 ose para publikimit të Raportit të radhës të rregullt të Komisionit Evropian për Maqedoninë.**

Reforma në jurisprudencë

Në pjesën e reformës në jurisprudencë, Qeveria i pranoi vërejtjet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian, Komisionit të Venedikut dhe GREKO-s, si dhe rekomandimet e Grupit të Ekspertëve të Lartë për sundimin e së drejtës. Qeveria punon në mënyrë intensive dhe të përkushtuar në ndërtimin e jurisprudencës së pavarur, objektive, profesionale dhe efikase. Për këtë qëllim, Qeveria do të miratojë Strategji të re për reforma në sektorin e jurisprudencës e cila do të paraqes udhërrëfyes në të cilin do të lëvizin reformat në sektorin e jurisprudencës, kthimin e besimit te institucionet, mundësimin e sigurisë juridike, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të veçanta të qytetarëve dhe ndërtimin e atmosferës në gjyqësinë e lirë, pa presione politike. Deri në fund të dhjetorit 2017 do të ndërpritet Këshilli për përcaktimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit, do të miratohen ndryshimet e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe do të publikohet Raporti me konstatimet dhe rekomandimet nga faza e parë e kontrollit të zbatuar për funksionimin e sistemit AKMIS. Në këtë periudhë do të propozohet pakoja e ndryshimeve ligjore lidhur me përforcimin e pavarësisë dhe objektivitetit, si dhe përmirësimi i punës së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

Në pjesën e reformës së sistemit të burgjeve, Qeveria i pranoi vërejtjet dhe rekomandimet e Komitetit për Parandalimin e Torturës së Këshillit të Evropës dhe mori masa për përmirësimin e kushteve dhe kapaciteteve të institucioneve përmirësuese ndëshkuese, zbatimin e sanksioneve alternative, si dhe përmirësimin e mbrojtjes dhe sigurisë shëndetësore.

Masat kryesore:

1. Miratimi i Strategjisë për reforma në sektorin e jurisprudencës për periudhën 2017-2022 me Planin Aksional	12/2017
2. Miratimi i Ligjit për shfuqizimin e Ligjit për Këshillin për përcaktimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë	12/2017
3. Raporti i parë nga kontrolli i zbatuar për funksionimin e sistemit AKMIS me konstatimet e përcaktuara për keqpërdorimet eventuale me rekomandime	12/2017
4. Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata në pjesën e bazave për përgjegjësinë disiplinore dhe masat disiplinore për gjykatësit, si dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë me qëllim të përmirësimit të procesit të vlerësimit të gjykatësve dhe kushteve për zgjedhjen e gjykatësve	1/2018
5. Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve	12/2017
6. Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve	1/2018
7. Miratimi i Strategjisë për Teknologjinë Komunikuese Informatike dhe Jurisprudencës	12/2017
8. Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për realizimin e sanksioneve	1/2018
9. Fillimi me punë i Zyrës së Probacionit në zonën e Gjykatës Themelore Shkupi 1 Shkup, si dhe sigurimi i personalit në Shërbimin e Probacionit	1/2018
10. Bartja e kompetencës për mbrojtjen shëndetësore të të burgosurve nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë	12/2017

Reforma në shërbimet e sigurisë dhe të zbulimit

Qeveria konsideron se reforma në shërbimet e sigurisë dhe të zbulimit është më se e domosdoshme. Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për reformë gjithëpërfshirëse, Qeveria do të sigurojë debat transparent dhe inkluziv, në të cilin procesi i konsultimeve do të zbatohet në mënyrë përkatëse. Në këtë drejtim është formuar Grupi i Punës i përbërë nga përfaqësuesit e institucioneve relevante, opozita dhe opinioni profesional, i cili ka për qëllim të përgatit plan të masave dhe aktiviteteve për tejkalimin e dobësive në sistemin e tanishëm të ndjekjes së komunikimeve, në interes të garantimit të ligjshmërisë, mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe sigurisë së shtetit dhe qytetarit. Në pajtim me këtë plan, reforma do të zbatohet konkretisht dhe në terren, në pajtim me dinamikën e përcaktuar për ndryshimet e nevojshme, me qëllimin final për kthimin e besimit të sistemi.

Në pjesën e reformës në polici, ka filluar procesi për vendosjen e mekanizmit të jashtëm të pavarur për kontrollin e punës së policisë që duhet të sigurojë objektivitet në veprimin në rastet kur ekziston dyshimi se janë kontestuese veprat penale nga të punësuarit në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Masat kryesore:

1. Miratimi i Planit për rekomandimet e zbatuara të Grupit të Ekspertëve të Lartë për çështjet sistematike nga sfera e sundimit të së drejtës në lidhje me ndjekjen e komunikimeve (2015/2017), me listën e akteve juridike, masave administrative dhe teknike, si dhe implikimeve financiare	11/2017
2. Miratimi nga Qeveria e pakos së ligjeve të domosdoshme për reformë në sistemin për ndjekjen e komunikimeve, si dhe vendosjen e mekanizmit të jashtëm	12/2017

3. Miratimi i Strategjisë Nationale të Republikës së Maqedonisë për luftën kundër terrorizmit me Planin Aksional	2/2018
4. Miratimi i Strategjisë Nationale të Republikës së Maqedonisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm me Planin Aksional	2/2018
5. Formimi i seksionit të veçantë në kornizat e Prokurorisë Publike Themelore për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit i cili do të jetë kompetent për ndjekjen penale të veprave penale të kryera nga të punësuarit në MPB me autorizime policore, si dhe nga pjesëtarët e policisë së burgut	3/2018
6. Formimi i njësisë së veçantë organizative të Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë si mekanizëm për kontrollin civil	3/2018

Kuvendi	
<i>Qeveria në kornizat e kompetencave të veta i mbështet masat për ripërtëritjen dhe zhvillimin e ambientit demokratik, nëpër dialogun politik dhe bashkëpunimin me të gjitha partitë parlamentare, veçanërisht me opozitën. Qeveria do të vazhdojë të jap kontribut në drejtim të sigurimit të kushteve për zbatimin e plotë të rekomandimeve të kontraktuara pas ngjarjeve të padëshiruara më 24/12/2012, lidhur me ngjarjet e dhunshme më 27/04/2017. Qeveria, partnerët e koalicionit dhe shumica në Kuvend, në bashkëpunim të hapur dhe të sinqertë me opozitën, do të mundësojë që funksioni mbikëqyrës i Kuvendit dhe trupave kuvendore mbi punën e Qeverisë dhe shërbimeve të saj të sigurisë dhe të zbulimit, të jetë i rregullt dhe rutinor, me shkallën më të lartë të mundshme të transparencës.</i>	
Masat kryesore të Kuvendit:	
1. Puna e rregullt dhe esenciale e mbikëqyrës së Komisionit për Mbikëqyrje mbi Punën e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë për Zbulim, dhe Komisionit për Mbikëqyrje mbi Zbatimin e Masës së Veçantë Hetuese Ndjekja e Komunikimeve nga Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria e Doganave dhe Ministria e Mbrojtjes, përmes mbledhjeve të rregullta në të cilat detyrimisht në mënyrë aktive do të marrin pjesë institucionet kompetente	Vazhdimisht
2. Përforcimi i kapaciteteve të anëtarëve të Komisionit për Mbikëqyrje mbi Punën e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë për Zbulim, dhe Komisionit për Mbikëqyrje mbi Zbatimin e Masës së Veçantë Hetuese Ndjekja e Komunikimeve nga Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria e Doganave dhe Ministria e Mbrojtjes, përmes bashkëpunimit aktiv me Qendrën e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF)	11/2017
3. Vazhdimi i punës së Grupit të Punës për reformat në Kuvend, me qëllim të arritjes së marrëveshjes së pranueshme politike për ndryshimet në Rregullore dhe përforcimi i kapaciteteve të pavarura të Kuvendit	01/2018
4. Bashkëpunimi aktiv me ekspertët e BE-së në Kuvend dhe përfshirja e tyre në Grupin e Punës për reforma në Kuvend	11/2017
5. Miratimi i kodeksit etik për deputetët, në pajtim me rekomandimet e Raportit më 24/12/2012 dhe GREKO-s	01/2018
6. Mbështetja aktive e Kuvendit përmes sigurimit të kushteve për funksionimin dhe demonstrimin e mbështetjes politike për punën e grupeve me interes multipartiake të deputetëve dhe Klubit të Deputetëve të Rinj	11/2017
7. Pjesëmarrja proaktive e grupeve parlamentare në iniciativat ndërkombëtare dhe	Vazhdimisht

inicimin e iniciativave të pavarura kuvendore për përmirësimin e besimit dhe avancimit të dialogut ndërmjet shumicës dhe opozitës	
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--

Emërimet	
<i>Qeveria obligohet t'i respektojë në tërësi procedurat dhe kriteret ligjore gjatë emërimit të personave në pozicione udhëheqëse, si dhe anëtarëve të këshillave drejtuese dhe mbikëqyrëse. Gjithashtu, Qeveria do të përpiqet edhe më tutje të sigurojë funksionim të papenguar të të gjitha institucioneve shtetërore, duke e përfshirë edhe rrjetin diplomatik, me respektim të plotë të kompetencave të përkufizuara kushtetuese dhe ligjore.</i>	
Masat kryesore:	
1. Emërimet e personave në pozicione udhëheqëse përmes procedurës transparente dhe konkurrenente në pajtim me kornizën juridike	3/2018
2. Emërimet e anëtarëve të rinj kompetentë të këshillave drejtuese dhe mbikëqyrëse në pajtim me kornizën juridike	3/2018
3. Vazhdimi i konsultimeve me Presidentin e RM-së për plotësimin e vendeve të zbrazëta në përfaqësitë konsullore diplomatike	3/2018

Reforma në administratën publike dhe menaxhimin e mirë	
<i>Reforma në administratën publike (RAP) është njëri ndër prioritetet kryesore të Qeverisë, që filloi me përgatitjen e Strategjisë së realizueshme, gjithëpërfshirëse dhe cilësore për RAP-in. Qëllimet kryesore të RAP-it janë departizimi dhe profesionalizimi i administratës, si dhe ndërtimi i administratës së orientuar në servis dhe në cilësi e cila do të funksionojë dhe punojë në kushte të përmirësuara. Me përforsimin e interoperabilitetit, rritjen e numrit të e-shërbimeve dhe zbatimin e teknologjive informatike moderne, Qeveria synon në digjitalizimin për sigurimin e shërbimeve të shpejta, të rëndomta dhe lehtë të arritshme për qytetarët.</i>	
<i>Në pjesën e menaxhimit të mirë, Qeveria do të publikojë Buxhet Civil për Buxhetin për vitin 2018, me qëllim qytetarët të kenë fotografi të kuptueshme për shpenzimin e financave publike. Gjithashtu, Qeveria do të miratojë Program për reforma në menaxhimin me financat publike për vitet 2018-2021, i cili duhet të sigurojë stabilitet dhe përforsim të planifikimit afatmesëm.</i>	
Masat kryesore:	
1. Miratimi i Strategjisë për reformë në administratën publike për vitet 2018-2022 me Planin Aksional	12/2017
2. Formimi i Këshillit për reformë në administratën publike, i ngarkuar për koordinim në procesin e RAP-it dhe i kryesuar nga KQRM-ja	12/2017
3. Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për nëpunës administrativë	1/2018
4. Miratimi i Drejttimeve për menaxhimin e mirë të personave të zgjedhur dhe të emëruar në pushtetin ekzekutiv	3/2018
5. Përgatitja e Strategjisë për të Dhënat e Hapura	3/2018
6. Miratimi i Programit për reforma në menaxhimin me financat publike për vitet 2018-2021	12/2017
7. Publikimi i Buxhetit Civil për Buxhetin për vitin 2018	11/2017
8. Konsultimet publike për reformë në sistemin e furnizimeve publike dhe pranimin e	11/2017

sugjerimeve të SIGMA-s në aspekt të sistemit për furnizime publike dhe Këshillit	
9. Hartimi i Dokumentit për politikë për reforma në kontrollin financiar të brendshëm publik	3/2018

Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit	
<i>Qeveria synon se lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit do të jetë efikase nëse hetimet inician dhe mbahen në mënyrë ligjore, sipas parimeve të objektivitetit. Si rrjedhojë, prioritet kryesor është përforsimi dhe avancimi i mekanizmave për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe lirimi i tyre nga ndikimet dhe presionet politike. Në këtë proces, tërësisht do të merren parasysh rekomandimet e ekspertëve të huaj dhe vendorë, si dhe shoqëria civile.</i>	
Masat kryesore:	
1. Vendosja e minimum standardeve për mbrojtjen fizike, administrative, informatike dhe teknike në Seksionin për Parandalimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në kornizat e Ministrisë së Punëve të Brendshme	3/2018
2. Plotësimi teknik material i Qendrës Koordinuese Nacionale për luftën kundër krimit të organizuar	12/2017
3. Miratimi i Strategjisë së Republikës së Maqedonisë për përforsimin e kapaciteteve për mbajtjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pronës, me Planin Aksional për zbatimin e saj	12/2017
4. Zbatimi i rekomandimeve të GREKO-s nga rrethi IV i evalvimit të cilat deri tani nuk janë zbatuar dhe të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e korrupsionit të deputetët, gjykatësit dhe prokurorët publikë	3/2018

Mediet	
<i>Mediet si shtylla të një shoqërie demokratike dhe gazetarët kanë mbështetje të fuqishme nga Qeveria e cila fuqishëm është e përcaktuar në respektimin e lirisë së të shprehurit, punën objektive dhe profesionale të medieve dhe gazetarëve, pa kurrfarë ndikimi politik, presione apo dhunë nga çfarëdo lloji. Qeveria është e përkushtuar në krijimin e kushteve për pavarësinë e plotë dhe profesionalizimin e servisit radiodifuziv publik (RTM) dhe pavarësia dhe lirimi i plotë nga çfarëdo ndikimi në rregullatorin Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Qeveria ndërton partneritet me shoqatat mediatike dhe sektorin civil, me qëllim të sigurojë kushte për punën objektive të të gjitha medieve tjera, sepse interes i të gjithë qytetarëve është të njoftohen saktë dhe me kohë. Qeveria do të hap proces të gjerë konsultativ me bashkësinë mediatike dhe organizatat civile për ndryshimet e mundshme të Ligjit për qasje të lirë të informatat me karakter publik dhe Ligjit për medie, si dhe për masat e mundshme për lehtësimin e punës së medieve të shtypit.</i>	
Masat kryesore:	
1. Hapja e dialogut me bashkësinë e medieve dhe organizatat civile për ndryshimet e mundshme të Ligjit për qasje të lirë të informatat me karakter publik	12/2017
2. Hapja e diskutimit publik për ndryshimet e mundshme të Ligjit për medie	12/2017
3. Hapja e diskutimit të mundshëm për masat e mundshme për lehtësimin e punës së medieve të shtypit	12/2017
4. Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale	3/2018
5. Miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Ndërmarrjes Publike „Radiodifuzioni i Maqedonisë“	3/2018

Shoqëria civile	
<p>Qeveria konsideron se shoqëria civile është partner i barabartë dhe korrigjues i vendimeve të saj, me të drejtën e plotë të participojë, të sugjerojë dhe të kritikojë në ndërtimin e politikave. Qeveria në mënyrë aktive merr masa për ndërtimin e dialogut të vazhdueshëm, transparent dhe të plotë inkluziv me shoqërinë civile. Deri në fund të vitit 2017, Qeveria do të vendos Këshill funksional për bashkëpunim dhe zhvillim të sektorit civil pas konsultimeve të zbatuara gjithëpërfshirëse me organizatat civile dhe procedurën transparente për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit. Duke i shfrytëzuar si bazë analizat dhe dokumentet strategjike të organizatave civile dhe me pjesëmarrjen e tyre të drejtpërdrejtë dhe esenciale, në mars 2018, Qeveria do të miratojë Strategji të re për bashkëpunim me sektorin civil me Planin Aksional për periudhën 2018-2020. Për shkak të sigurimit të mjedisit të sigurt për zhvillimin e shoqërisë civile, Qeveria do ta informojë opinionin për rrjedhën e hetimeve të zbatuara të orientuara në organizatat civile.</p>	
Masat kryesore:	
1. Miratimi i Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për formimin e Këshillit për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe sektorit civil, pas konsultimeve të zbatuara gjithëpërfshirëse me organizatat civile dhe zbatimin e procedurës transparente për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit	12/2017
2. Miratimi i Strategjisë së re për bashkëpunimin e Qeverisë me sektorin civil, me Planin Aksional për zbatim për periudhën 2018-2020	3/2018
3. Informimi i opinionit për hetimet e zbatuara për frikësimin dhe presionin ndaj organizatave civile	12/2017
4. Miratimi i Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin personal mbi të ardhura	12/2017
5. Fillimi i dialogut për përgatitjen e modelit të qëlluar për trajtimin tatimor të organizatave civile nga aspekti i tatimit mbi fitim	12/2017
6. Publikimi dhe azhurnimi i vazhdueshëm i regjistrit të organizatave civile në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione dhe e-mail adresat respektive në faqen e Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë	12/2017

Zgjedhjet	
<p>Në pjesën e zgjedhjeve, Qeveria i pranoi rekomandimet e OSBE/ODIHR-së dhe Komisionit të Venedikut dhe u obligua të hap debat gjithëpërfshirës për kornizën ligjore dhe institucionale për sistemin zgjedhor në bazën transparente dhe inkluzive.</p>	
Masat kryesore:	
1. Hapja e debatit gjithëpërfshirës me të gjithë faktorët relevantë për kornizën ligjore dhe institucionale për sistemin zgjedhor në bazë të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-së dhe ekspertit të Këshillit të Evropës	12/2017
2. Përkufizimi dhe miratimi i Projekt-planit për reformat e sistemit zgjedhor. Zbatimi i reformës fillon menjëherë dhe duhet të përfundojë së paku gjashtë muaj para zgjedhjeve të ardhshme	01/2018

Migrimet dhe menaxhimi kufitar	
<p>Qeveria konsideron se politikat e migrimëve dhe menaxhimit kufitar janë çështje mjaft të rëndësishme dhe rrjedhat e tyre ndikojnë në orientimin e zhvillimit socio-ekonomik të shtetit, si dhe orientimin dhe</p>	

kontrollin e masave të cilat merren për mbrojtjen e sigurisë së shtetit dhe qytetarëve. Në këtë drejtim, ekipi negociues i formuar nga Qeveria i filloi negociatat me Komisionin Evropian për Marrëveshjen e Statusit me Shërbimin Evropian për Rojën Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEKS). Gjithashtu, në drejtim të harmonizimit të legjislacionit i cili e rregullon çështjen e të drejtave dhe obligimeve të të huajve, si dhe realizimin e së drejtës së azilit, janë përgatitur projektet e Ligjit për mbrojtjen ndërkombëtare dhe të përkohshme dhe Ligjit për të huaj.

Masat kryesore:

1. Nënshkrimi i Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian, për aksionet e zbatuara nga Shërbimi Evropian i Rojës Kufitare dhe Bregdetare në Republikën e Maqedonisë – FRONTEKS	1/2018
2. Lidhja e Memorandumit ndërmjet Prokurorisë Publike të RM-së dhe MPB-së në lidhje me përforsimin e bashkëpunimit për luftën kundër kontrabandimit të emigrantëve dhe tregtisë me njerëz	11/2017
3. Miratimi i Ligjit për mbrojtjen ndërkombëtare dhe të përkohshme	2/2018
4. Miratimi i Ligjit për të huaj	3/2018
5. Hartimi i analizës së rrezikut për menaxhimin e integruar kufitar (MIK) në MPB	11/2017
6. Miratimi i Planit Aksional për vitin 2018 me masat për zhvillimin e MIK-ut, në pajtim me vlerësimin e Strategjisë Nacionale për MIK-un (2015-2019)	12/2017
7. Formimi i qendrës analitike në QKNMIK, për hartimin e analizave të rrezikut në nivelin strategjik në pajtim me standardet e CIRAM-it të Fronteksit	12/2017

Marrëveshja e Ohrit

Në pjesën e zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit, në frymën e kohezionit, Qeveria u kontraktua për avancimin e zbatimit të elementeve legjislative.